



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

**E K S T R A K T**

**i procesverbalit i Dëgjimit publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024. Identifikimi i kërkesave të sportistëve, rinisë, OJQ-ve, për vitin 2024, mbajtur më 10.7.2023, duke filluar nga ora 14:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Osman Bllaca-kryesues, Valbona Makolli- drejtore e Drejtorisë së Financave, Mimoza Sylejmani- drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Lulzim Fushtica- drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Adelina Sahiti- drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova- drejtor i Drejtorisë së Sportit, Arta Balaj- drejtore e Drejtorisë së Kulturës.

**Të pranishëm ishin edhe:** Fadil Gërguri, Ajete Kërçeli, Jetëbardha Selmani, Erza Kurti, Egzona Gashi, Leart Sadiku, Erëza Qorri, Agnesa Krasniqi, Leorenta Alija, Pëllumb Bajqinovci, Endrit Zabërgja, Besart Peshku dhe Naser Krasniqi.

Takimin e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**.

**Osman Bllaca, kryesues:-** përshëndeti të pranishmit dhe sqaroi se diskutimi buxhetor ka për qëllim hartimin e buxhetit për vitin 2024. Ai tha se hapi i parë ka qenë Korniza afatmesme buxhetore, ku në vija të trasha për projekte kapitale, është bërë planifikimi për tri vitet e ardhshme, për vitin 2024, 2025, 2026, i cili është miratuar në mbledhjen e fundit më 27.6.2023, në Kuvendin Komunal, ndërsa hapi i dytë është hartimi i buxhetit, për të cilat prej sot fillohet me ciklin e 5 dëgjimeve buxhetore, të specifikuar në bazë të rëndësisë dhe fushave me të cilat edhe hartohet buxheti. Ai tutje tha se aktiviteti i datës 10.7.2023 është ndarë për identifikimin e kërkesave të sportistëve, rinisë, dhe OJQ-ve, për projekte të subvencioneve për planifikimin e buxhetit të vitit 2024 dhe ia dha fjalën drejtores Valbonë.

**Valbona Makolli, drejtore:** - përshëndeti dhe falënderoi të gjithë dhe tha se do të mundohen që të gjitha kërkesat e tyre të përfshihen në propozimbuxhetin për vitin 2024, aq sa ka mundësi dhe kufij buxhetor. Ajo tutje tha se këto projekte janë propozuar dhe aprovuar në Kuvend, të cilat janë bërë për secilën drejtori ku përfshihen investimet kapitale.

Gjithashtu ajo njoftoi se sipas Qarkores 01/2023 që kanë pranuar nga Ministria e Financave për vitin 2023 lidhur me buxhetin e kryeqytetit për vitin 2024 janë të parapara, **122.790.872** euro të ndara në 5 kategori: në mallra dhe shërbime, subvencione, paga dhe mëditje, komunalit dhe investime kapitale, duke theksuar gjithashtu se për vitin 2024 kryeqyteti ka obligim të mbledhë të hyra vetanake në vlerë prej **38.778.968** euro. Ajo falënderoi pjesëmarrësit e pranishëm duke njoftuar për dëgjimet publike që do të pasojnë dhe ftoi të gjithë qytetarët të bashkëngjiten, për t'i shprehur kërkesat e tyre.

**Naser Krasniqi, udhëheqës i Klubit të Volejbollit të Vajzave:** - tha se shqetësimi i tij lidhur me infrastrukturën sportive, dhe mungesën e palestrave sportive funksionale në Prishtinë nuk është temë e re, por është që nga paslufta e tutje. Ai theksoi se në Prishtinë janë vetëm dy palestra funksionale, të brendshme që ka aktivitet si basketboll, hendboll, volejboll, krahasuar me vitet 80 ku kanë qenë tri palestra dhe ka pas popullatë, e klube më pak. Z. Krasniqi për vitin 2024 përveç palestrës multifunksionale, për të cilën nuk kanë shumë informata as për lokacion as për funksion, propozoi që komuna t'i ndajë disa parcela dhe të ndërtojë palestra shumë më të vogla, shumë më pak të kushtueshme, mirëpo në anën tjetër e kishin zbutur shumë edhe kërkesën e shumë klubeve të cilat janë të krijuara në Prishtinë. Problem tjetër sipas tij janë subvencionet për të cilat i është drejtuar drejtorit të Drejtorisë së Sportit, se kriteri gjatë ndarjes së tyre për klube sportive duhet të rishqyrtohet, sepse ai thotë që nuk ka kriter dhe se nuk ndahen subvencionet sipas rangimit të klubeve sportive, sepse të gjitha nuk janë të ranguar nëpër liga, superliga, por kemi raste kur subvencionet i marrin klubet të cilat janë të ranguar në nivele shumë më të ulëta në krahasim me klubet të cilat janë superiore dhe kësaj komune i kanë sjellë shumë tituj. Pra ai kërkoi një rishqyrtim të kategorizimit gjatë ndarjes së subvencioneve.

**Fadil Gërguri, nga klubi i Aeronautikës “Paragliding” Prishtinë:** - tha se ka biseduar edhe më herët me drejtorin për ndërtimin e një qendre të aterimit, një fushe të aterimit tek liqeni i Badovcit, ku aty edhe e zhvillojnë aktivitetin, duke kërkuar nga komuna që ajo pjesë të lihet vetëm për aeronautikë, për shkak se është e vetmja Prishtina, që nuk ka terren të paraglidizimit.

**Erza Kurti, nga organizata “ Qendra për liri dhe barazi për komunitetet LGBT”:** - shprehu keqardhje që pa kaq pak aktivitete dhe kaq pak buxhet të ndarë, vetëm për mirëqenie sociale dhe fushën e kulturës edhe pse organizatat joqeveritare më së shumti fokusohen në këto pika. Ajo tha se dëshiron të pyes për strehimoren për personat e LGBT, të cilët përjetojnë dhunë në familje ose kudo për të cilën është biseduar para tri viteve, por Prishtina ende nuk e ka një strehimore të sigurt, dhe për Qendrën “Drop-in”, që është premtuar para tri viteve, ku organizatat joqeveritare shumë shpesh e kanë mbajtur në lokacione të ndryshme me të hyra vetanake. Pra ajo pyeti se ku qëndrojnë me procesin dhe pse nuk janë të përfshirë në Plan Buxhetor.

**Ajete Kërqeli, nga "Fondacioni 17":** - tha se po gëzohet shumë që është në plan për t'u rifunksionalizuar objekti i “Kino Rinisë”, duke shtuar që në rendin e përpjekjeve të mira të Komunës së Prishtinës në bashkëpunim me organizatat e kulturës për funksionalizimin e hapësirave të ndryshme publike, të parashihet ndonjë linjë e veçantë, që vazhdon të investojë në infrastrukturë të këtyre hapësirave publike për t'i bërë të qasshme edhe për personat me aftësi të kufizuara. Ajo mori shembull shtëpinë e Hivzi Sylejmanit, që është një objekt fantastik dhe është duke u ofruar një program shumë i mirë, mirëpo shtëpia nuk i ofron kushtet për të qenë e qasshme për personat me aftësi të kufizuara, që besoi është problem i njëjtë për të gjitha qendrat që aktualisht janë duke operuar në Prishtinë dhe ndoshta kishte me qenë mirë ta kemi një linjë të veçantë për përmirësimin e infrastrukturës së këtyre hapësirave ekzistuese për t'i bërë të qasshme për të gjitha grupet e ndryshme shoqërore në Prishtinë dhe në të njëjtën kohë me pas një mirëmbajtje të rregullt që mundëson një operim pa ndërprerje përgjatë vitit.

Znj. Kërqeli tha se kërkesa e vazhdueshme që ata, e kanë është që të rritet tavani i subvencioneve sepse programi vjetor që shumica nga organizatat kulturore ofrojnë është jashtëzakonisht i pasur dhe ofrohet për një audiencë të gjerë, që nënkupton që edhe nevojat për subvencione janë më të mëdha dhe me pas programin përgjatë tërë vitit.

**Jetëbardha Selmani, nga “Down Sindrom- Kosova”:** - pyeti lidhur me shërbimet e “Down Sindrom-Kosova”, se a është planifikuar që nga viti 2024 t'i mbulojë Komuna ose diçka e tillë, pasi që është prezantuar formula financiare edhe në takimet paraprake, për arsye se deri më tani shoqata vetëm

subvencionohet nga Komuna, por ajo tha se e kanë prezantuar formulën e tyre financiare se sa kushton për t'ju dhënë shërbim personave me Sidnromën Down, në atë qendër, duke i llogaritur kostot mujore dhe vjetore se sa kushtojnë.

**Granit Rugova, drejtor:** - iu përgjigj fillimisht trajnerit për Sallën multifunktionale, për të cilën tha se do të vendoset në Bërnice tek Kampusi Sportiv me kapacitet prej 8000 ulëse, në mënyrë që aty të zhvillohet çfarëdo aktiviteti ndërkombëtar. Sa i përket palestrave të vogla drejtori tha se janë shumë të nevojshme sepse ka numër të madh të klubeve në Prishtinë dhe ka shumë pak hapësira, duke shtuar se do të kërkojnë buxhet te Kryetari, të financat nëse ka mundësi për ta hedhur në buxhet edhe një sallë të vogël, por në të njëjtën kohë ai tregoi se janë duke u ndërtuar edhe tri shkolla të cilat do të kenë salla të vogla, e të cilat pas orarit të mësimit mund të shfrytëzohen nga klubet e qytetit. Sa i përket subvencioneve të klubeve, ai tha se do t'i shqyrtojnë dhe do t'ju kërkojnë federatave rezultatet dhe informata, që në fund ndarja të bëhet me meritokraci. Drejtori po ashtu ju përgjigj z. Gërguri, duke thënë se kanë gjetur një hapësirë të përshtatshme për paragllajdzëm në Badovc, dhe se kërkesa që ai e kishte këshilluar për të bërë tek Kryetari dhe prona është duke u shqyrtuar me shpresë që sa më shpejtë do t'i kthejnë përgjigjen dhe të fillohet për ta shtyrë përpara atë sport të mirë.

**Adelina Sahiti, drejtoreshë:** - tha se kur bëhet fjalë për strehimoren për komunitetin LGBT, u përgjigj se kanë pasur takime të shumta, nga niveli i Kryetarit Rama, i cili ka pritur disa herë përfaqësuesit e këtij komuniteti dhe dy organizatat edhe CEL-in, Arbër Nuhiun edhe Blertin, ku kanë diskutuar për strehimoren, e cila është e domosdoshme dhe mëse e nevojshme për komunitetin LGBT, i cili pëson dhunë nga familja, abuzime dhe keqtrajtime të formave të ndryshme. Ajo tha se i kanë pritur edhe në takim bashkë me drejtorin e QPS-së, ku kanë biseduar me ta dhe i kanë kërkuar që të tregojnë saktë se si do të trajtohen personat e keqtrajtuar, çfarë funksioni do ta kryejë strehimorja, a janë të licencuar, dhe ata janë përgjigjur se nuk kanë licencë. Ajo tha se nuk kanë një model askund në Evropë se si do të duhej trajtuar këta persona, çfarë specialisti duhet të jetë aty, a duhet të jenë të ndarë të rriturit dhe të miturit sepse ekziston rreziku, duke theksuar se kanë pasur shumë dilema të cilat i kanë kërkuar. Tutje tha se ata janë të zotuar që të jenë pranë çdo qytetari, por ata duan një ekspertizë një licencë. Drejtorja sqaroi se licencat për shërbime sociale merren në Këshillin e Përgjithshëm për Çështje Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Drejtësisë, ku tregohet që personi i cili ofron atë shërbim, i ka të gjitha, shkollimin adekuat, të gjitha trajnimet e nevojshme për ta trajtuar këtë komunitet dhe se çështja ka mbetur që Arbri bashkë me Blertin të cilët i përfaqësojnë dy organizatat, të tregojnë ekspertizën e tyre dhe pastaj të fillohet. Ajo tha se kanë gatishmëri dhe se i kanë pasur edhe mjetet të cilat edhe nëse janë larguar për këtë vit, do të kthehen sërish, dhe nuk është problem i madh çështja e gjetjes së mjeteve, por është problem dhe rëndësi kryesore se kush do t'i ofrojë ato shërbime, si do të trajtohen këta fëmijë, këta të rritur. Për Qendrën "Drop-In" ajo u shpreh se kanë dhënë një lokacion bashkë me NPB-në, që 3 vite e kanë atë hapësirë dhe në takime të ngushta me përfaqësuesit është thënë që kanë një peticion të banorëve që nuk po e duan këtë "Drop-In" aty. Drejtorja tha se kanë pyetur komunitetin se a do të vendosen në atë lokacion apo ku, pasi që inventari është i gatshëm duke pritur, por ende s'kanë marrë përgjigje zyrtare.

**Erza Kurti:** - tha se pasi ekziston gatishmëria nga komuna, beson që ndoshta vitin e ardhshëm do të mund të realizohen "Drop-in" dhe strehimorja.

**Adelina Sahiti, drejtoreshë:** - u përgjigj se ata kanë qenë të gatshëm afër një vit dhe që një vit e më shumë janë duke pritur përgjigje prej Arbrit. Sa i përket "Down Sindrom"- Kosova, ajo u shpreh se jemi me fat si Kryeqytet dhe si Kosovë që do ta kemi qendrën e parë ku do të ofrohen shërbime të specializuara, shërbime që do të jenë model jo vetëm për Ballkanin, por edhe për Evropën, sepse nuk ka të tilla përveçse në Turqi, pra një qendër model për Sindrom Down dhe autizëm. Drejtorja tha se janë duke pritur me padurim që ta

hapim dhe që fëmijët dhe të rriturit të marrin trajtime sipas standardeve më të larta evropiane. Ajo tha se janë duke kontaktuar ngushtë edhe me “Down Sindrom” edhe me “Autizëm”, dhe janë për të bërë një zgjidhje më të mirë të mundshme, për të cilën ka ndihmuar edhe Drejtoria e Financave, drejtorja Valbona të cilën ajo e falënderoi shumë, për angazhimin në këtë proces. Pastaj tha se janë zotuar si kryeqytet që do të marrin përsipër mbulimin e shpenzimeve të komunalive sepse siç e potencove edhe ti, ne si kryeqytet në baza vjetore gjithmonë i mbështesim shërbimet që ofron Shoqata “Sindrom Down” dhe dhjetëra shoqata tjera që ofrojnë shërbime sociale. Në fund tha se ka pasur 10 objekte pa pagesë i ka shfrytëzuar, ka pasur edhe subvencione, ndihmesa, lehtësira, duke treguar se së shpejti do të finalizojnë një marrëveshje mes akterëve, komunës dhe organizatave, por tha që nuk dëshiron të nxitohet sepse ende nuk është nënshkruar por e rëndësishme është që do të ketë lajme të mira.

**Naser Krasniqi**, pyeti se a ekziston mundësia që komuna me pas një parcelë, për një palestër sportive, sepse kanë biseduar më herët me disa investitorë, por duhet parcela.

**Mimoza Sylejmani, drejtore:** - u përgjigj se bashkë me Kryetarin Rama, dhe me drejtorin e sportit veç e kanë gjetur lokacionin ku është duke u planifikuar një masterplan, është themeluar grupi punues dhe të gjitha sportet do të shkojnë në zonën të panairit në Bërnice që është zona kadastrale dhe aty do të orientohen të gjitha, ku do të ketë edhe një pishinë të hapur olimpikë dhe shumë shpejt do të kemi një masterplan për një qendër të madhe sportive dhe të gjitha objektet do të fokusohen aty.

**Naser Krasniqi:** - tha se është i informuar për këtë palestër multifunksionale, me interes të përgjithshëm të të gjitha sporteve me karakter nacional, por një ekipi të Prishtinës për me udhëtuar deri atje në ditë për të ushtruar ka një kosto, por ai tha se dëshiron të gjejë një palestër shumë më të vogël jomultifunksionale, e cila do t'i plotësojë kërkesat për sportin me dorë, pa pas nevojë për të udhëtuar atje, por me qenë diku rreth Prishtinës.

**Mimoza Sylejmani, drejtore:** - tha se janë në proces të Planit Zhvillimor Komunal, dhe janë duke kërkuar toka komunale, duke diskutuar me Drejtorinë e Pronës dhe AKP-në, pasi që AKP-ja posedon më shumë prona se ata dhe nuk është që nuk është diskutuar, por është problem me gjet toka më afër p.sh në qendër, madje edhe për shkolla dhe çerdhe por ajo shpreson që të gjendet një lokacion i tillë.

**Arta Balaj, drejtore:** - iu përgjigj znj. Ajete lidhur me kërkesat për rritjen e subvencioneve të cilat ajo tha se kanë qenë edhe kërkesa të saj dhe të drejtorit të sportit, Granitit. Ajo tha se këtë vit kanë pranuar kërkesa për subvencione diku mbi **pesë milionë**, kurse në dispozicion kanë pasur **750 mijë euro** për të i shpërndarë. Pra ajo tha se kjo vlerë duhet të rritet, sidomos për programet vjetore që nuk janë mbështetur sa duhet d.m.th programet vjetore, festivalet e rëndësishme për qytetin tha se patjetër do të përkrahen pak më shumë. Ajo informoi se shumë shpejtë këtë javë do të publikohen listat e subvencioneve, të Drejtorisë së Kulturës, ndërsa sa i përket rregullimit të infrastrukturës për njerëzit më nevojta të veçanta ajo shpreson që do ta bëjnë një bashkëpunim me drejtorin e Drejtorisë së Emergjencave dhe Sigurisë, që edhe objektet kulturore të kenë qasje sa më të mirë.

**Lulëzim Fushica, drejtor:** - tha se sa i përket aspektit të qasjes për personat me aftësi të kufizuara por jo vetëm javën e kaluar është hartuar projekti “Prishtina një qytet pa barriera”, ku është nënshkruar marrëveshje me memorandum bashkëpunimi me znj. Elvana Shala, që është ambasadore e vullnetit të mirë dhe është krijuar grupi punues, i cili ka për detyrë të identifikojë të gjitha pronat, ndërtesat si ndërtesat komunale, institucionet që të shikohet se cilat nga ato kanë qasje apo nuk kanë qasje. Ai tha se do të përmirësohet infrastruktura si për personat me aftësi të kufizuara, për fëmijët dhe personat e moshuar. Drejtori shpjegoi se para një muaji kanë filluar inspektimin e të gjitha shkollave fillore, shkollave të mesme dhe institucioneve

parashkollore, për të shikuar se ku ka nevojë për intervenime në aspekt të qasjes me të lehtë, pasi që shumica nuk kanë shkallë as dalje emergjente, si dhe do të bëhet një vlerësim i gjithë kryeqytetit në këtë aspekt dhe kjo do të jetë pjesë e planifikimit buxhetor për vitin 2024, ku janë përfshirë të gjithë drejtorët që kanë ndikime direkte apo indirekte, Drejtoria e Sigurisë, Mirëqenies Sociale, Urbanizmit, Planifikimi Strategjik, Administrata, Arsimi, Shëndetësia, Kultura edhe Shërbimet Publike. Ai theksoi se Drejtoria e Sigurisë, prek të gjitha aspektet e punës të çdo drejtorie në kryeqytet.

**Osman Bllaca, kryesues** mbylli debatin, duke lënë takim për debatin tjetër të nesërmen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Dëgjim publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024;

10.07.2023

Ora 14:00

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Gjinia	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	FADIL GJERGUR					
2	AJETE	KERESLI				
3	Jetbardha	Selmuni				
4	Erza	Kurti				
5	Esena	Gani				
6	Lent	Sokolaj				
7	Erza	Qosri				
8	Agnesa	Krasnigj				
9	dearanta	Alija				
10	Pellumb	Bajnovca				

*P.S \*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do*

*të përdoren për qëllime tjera!*

*\*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!\**

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	Gjinia	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Besart	Pesku				
12	Hanser	Krasnigj				
13	ENPRIT	ZABERGJA				
14						